

## Formular për SYLLABUS të Lëndës

<b>Të dhëna bazike të lëndës</b>	
<b>Njësia akademike:</b>	<b>Fakulteti i Mjekesise</b>
<b>Titulli i lëndës:</b>	<b>Mjekesi Interne (drejtimi: MP)</b>
<b>Niveli:</b>	<b>Bachelor, Master</b>
<b>Statusi lëndës:</b>	<b>Obligative</b>
<b>Viti i studimeve/Semestri:</b>	<b>III dhe IV/ Semestrat: VI, VII dhe VIII</b>
<b>Numri i orëve në total:</b>	<b>285</b>
<b>Vlera në kredi – ECTS:</b>	<b>15</b>
<b>Koha / lokacioni:</b>	<b>Sipas orarit/ Klinika Interne</b>
<b>Mësimdhënësi i lëndës:</b>	<p>Prof.dr.Gani Bajraktari, dr sc            Prof.asc.Sadik Zekaj, dr sc            Prof.asc.Emrush Kryeziu, dr sc.            Prof.asc.Sylejman Rexhepi, dr sc            Prof.asc.Shpënd Elezi, dr sc.            Prof.ass.Shemsedin Sadiku, dr sc.            Ass.dr.Drita Berisha, dr sc.            Ass.dr.Kelmend Pallaska, dr sc.            Ass.dr.Lulzim Kamberi, dr sc.            Ass.dr.Aurora Bakalli, dr sc            Ass.dr.Merita Emini-Sadiku, dr sci            Ass.dr.Venera Berisha-Muharremi, dr sc.            Ass.dr.Edmond Haliti, PhD kandidat            Ass.dr.Afrim Poniku, PhD kandidat            Ass.dr.Rrezarta Alihajdari-Halili, PhD kandidat            Ass.dr.Xhevdet Krasniqi, PhD kandidat            Ass.dr.Arlind Batalli, PhD kandidat            Ass.dr.Rina Tafarshiku-Sejdiu, PhD kandidat            Ass.dr.Artan Ahmeti, PhD kandidat</p>
<b>Detajet kontaktuese:</b>	<p><b>Klinika Interne, kati i II-të, zyra e shefit të katedrës</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Personat kontaktues:               <ul style="list-style-type: none"> <li>- Shefi i Katedres: Prof.dr.Gani Bajraktari, dr sc.</li> <li>- Zv.shefi i Katedres: Ass.dr.Lulzim Kamberi, dr sc.</li> <li>- Sekretari i Katedres: Ass.dr.Edmond Haliti</li> </ul> </li> <li>- Konsultimet: Cdo dite pune: 13:00-14:00</li> </ul>
<b>Përshkrimi i lëndës</b>	Shtjellimi i problematikes mbi semundjet internistike, te patologjive mbi semundjet e gjakut, sistemit urinar, semundjeve endorkinologjike dhe çrregullimeve te metabolizmit, patologjise gastrointestinale e semundjeve te melçise, semundjeve te traktit respirator, atij kardiovaskular dhe semundjeve reumatizmale.
<b>Qëllimet e lëndës:</b>	

	Të shtjellohen teorikisht dhe të demonstrohen në praktikë sëmundjet e zemrës dhe të enëve të gjakut , sëmundjet e sistemit respirator, dhe te mediastinumit,. Të ofrohen njohuri për etiologjinë e tyre, pasqyrën klinike, komplikimet e mundshme, diagnostikimin, diagnozën diferenciale dhe mjekimin këtyre sëmundjeve.		
<b>Rezultatet e pritura të nxënies:</b>	Studenti duhet të mësojë (përvetësoj) metodat klinike bazë për ekzaminimin e pacientit me këto sëmundje internistike, të bëjë diagnostikimin e tyre, diagnozën diferenciale, të ordinoj terapinë dhe të përcjellë klinikisht efektin e saj. Ai duhet të bëjë diferencimin dhe menaxhimin e situatave urgjente në kushte jashtëspitalore, të identifikoj rastet të cilat kërkojnë trajtim spitalor në nivelet e shërbimeve shëndetësore sekondare ose terciare, si dhe të orientoj (udhëzoj) pacientin në institucionin përkatës mjekësor. Pas lëshimit nga spitali duhet të përcjellë gjendjen klinike të pacientit, të ordinoj terapinë sipas rekomandimeve ose në marrëveshje me specialistin. Studenti poashtu duhet të njoh masat parandaluese dhe aspektet epidemiologjike dhe sociale të këtyre sëmundjeve.		
<b>Viti i III-të, Semestri VI</b>			
<b>Kontributi në ngarkesën e studentit ( gjë që duhet të korrespondoj me rezultatet e të nxënies të studentit)</b>			
<b>Aktiviteti</b>	<b>Orë</b>	<b>Ditë/javë</b>	<b>Gjithësej</b>
Ligjërata	2	15 javë	30 orë
Ushtrime teorike/laboratorike			
Punë praktike	3	15 javë	45 orë
Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet			
Ushtrime në teren			
Kollokfiime,seminare	1	15 javë	15 orë
Detyra të shtëpisë			
Koha e studimit vetanak të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)			
Përgaditja përfundimtare për provim			
Koha e kaluar në vlerësim (teste,kuiz,provim final)			
Projektet,prezentimet ,etj			
<b>Totali</b>	<b>6</b>		<b>90 orë (5 ECTS)</b>

<b>Viti i IV-të, Semestri VII</b>			
<b>Kontributi në ngarkesën e studentit ( gjë që duhet të korrespondoj me rezultatet e të nxëniet të studentit)</b>			
<b>Aktiviteti</b>	<b>Orë</b>	<b>Ditë/javë</b>	<b>Gjithësej</b>
Ligjërata	2	15 javë	30 orë
Ushtrime teorike/laboratorike			
Punë praktike	3	15 javë	45 orë
Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet			
Ushtrime në teren			
Kollokfieme,seminare			
Detyra të shtëpisë			
Koha e studimit vetanak të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)			
Përgaditja përfundimtare për provim			
Koha e kaluar në vlerësim (teste,kuiz,provim final)			
Projektet,prezentimet ,etj			
<b>Totali</b>	<b>5</b>		<b>75 orë (4 ECTS)</b>
<b>Viti i IV-të, Semestri VIII</b>			
<b>Kontributi në ngarkesën e studentit ( gjë që duhet të korrespondoj me rezultatet e të nxëniet të studentit)</b>			
<b>Aktiviteti</b>	<b>Orë</b>	<b>Ditë/javë</b>	<b>Gjithësej</b>
Ligjërata	2	15 javë	30 orë
Ushtrime teorike/laboratorike			
Punë praktike	3	15 javë	45 orë
Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet			
Ushtrime në teren			
Kollokfieme,seminare	3	15 javë	45 orë
Detyra të shtëpisë			
Koha e studimit vetanak të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)			
Përgaditja përfundimtare për provim			
Koha e kaluar në vlerësim (teste,kuiz,provim final)			
Projektet,prezentimet ,etj			
<b>Totali</b>	<b>8</b>		<b>120 orë (6 ECTS)</b>
<b>Metodologjia e mësimdhënies:</b>	Ligjërata me diskutime interaktive, seminare,		

	ushtrime praktike, konsultime
<b>Metodat e vlerësimit:</b>	<p><i>Vlerësimi i studentit zhvillohet në tri faza: I, II, III</i></p> <p><i>I. Test Preliminar me shkrim- Për t'iu nënshtruar provimit përfundimtar studentit duhet të përgjigjet saktë në së paku 50% të të gjitha pyetjeve në test (me shkrim).</i></p> <p><i>II. Provimi Praktik- Kandidati i cili kalon testin preliminar fiton të drejtën për t'iu nënshtruar provimit praktik i cili përbëhet nga:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> <li><i>-Ekzaminimi subjektiv-Anamneza</i></li> <li><i>-Ekzaminimi objektiv i të sëmurit internistik</i></li> <li><i>-Ekzaminimet diagnostike ndihmëse (të dhënat bazë për EKG, Radiografi, strisho gjakut periferik, analizat laboratorike)</i></li> </ul> <p><i>III. Provimi teorik- Kandidati i cili kalon dy vlerësimet e para, fiton të drejtën për t'iu nënshtruar provimit teorik (me gojë)</i></p> <p><i>Kandidati i cili kalon pjesën e parë po nuk arrinë të kalojë në pjesët II dhe III, nuk ka nevojë që të nënshtrohet përsëri pjesëve I dhe II të vlerësimit në dy herët e ardhshme.</i></p> <p><i>Nota përfundimtare-</i></p> <ul style="list-style-type: none"> <li><i>10-i shkëlqyeshëm</i></li> <li><i>9-shumë i mirë</i></li> <li><i>8-mesatar</i></li> <li><i>7-i mirë</i></li> <li><i>6-i kënaqshëm</i></li> <li><i>5-jo i kënaqshëm (i dobët)</i></li> </ul>
<b>Literatura</b>	
<b>Literatura bazë:</b>	<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Fauci A, Braunwald E et all. <i>Harrison's Principles of Internal Medicine</i>, 17<sup>th</sup> Edition, International edition, 2008</li> <li>2. Grup Autorësh. <i>Parimet e Mjekësisë së Përgjithshme</i>. Tiranë, 2002</li> <li>3. Kumar P, Clark M. <i>Kumar &amp; Clark Clinical Medicine</i>, 6<sup>th</sup> Edition, International edition, 2005</li> <li>4. Vrhovac B, Francetic I, Jaksic B, Labar B, Vucelic B. <i>Interna Medicina</i>, Zagreb, 2003</li> </ol>

<p><b>Literatura shtesë:</b></p>	<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Boon A.N, Colledge R.N, Walker B.R, Hunter J. Davidson's Principles and Practice of Medicine, 20<sup>th</sup> Edition, International edition, 2006</li> <li>2. Grup Autorësh. Sëmundjet e Zembrës. Tiranë, 2001</li> <li>3. Spahiu I dhe bp. Pneumoftizilogjia. Prishtine, ?</li> <li>4. Resuli B, Prifti S, Bibolli I, Kajo I, Basho J. Babameto A. Gastroenterologjia. Tiranë, 2000</li> <li>5. Resuli B, Prifti S, Bibolli I, Kajo I, Basho J. Babameto A. Hepatologjia. Tiranë, 2000</li> <li>6. Ylli A, Agaçi F. Endokrinologjia, Diabeti, Metabolizmi. Tiranë, 1999</li> <li>7. Grup autorësh. Nefrologjia. Tiranë. 2000</li> <li>8. Tafaj A. Reumatologjia. Tiranë, 2004</li> </ol>
----------------------------------	--

<b>Plani i dizajnuar i mësimit: Viti i III-të, Semestri VI</b>	
<b>Java</b>	<b>Ligjerata që do të zhvillohet</b>
<b>Java e parë:</b>	Metodat diagnostike joinvazive në Kardiologji Metodat diagnostike invazive në Kardiologji Ethet reumatike
<b>Java e dytë:</b>	Veset e fituara të zezrës (veset e valvulës mitrale dhe trikuspidale) Veset e fituara të zezrës (veset e valvulës aortale dhe pulmonare) Veset e kongjenitale të zezrës (pa shunt)
<b>Java e tretë:</b>	Veset e kongjenitale të zezrës (me shunt) Endokarditet Sëmudjet e miokardit (Miokarditet, miokardiopatitë)
<b>Java e katërt:</b>	Miokardiopatitë (dilatative) Miokardiopatitë (hipertrofike, restriktive dhe format e tjera) Pamjaftueshmëria e zezrës
<b>Java e pestë:</b>	Sëmudja iskemike e zezrës-epidemiologjia, etiologjia, patogjeneza, patofiziologjia, Sëmudja iskemike e zezrës- pasqyra klinike, format klinike të saj dhe diagnostikimi Sëmudja iskemike e zezrës-komplikimet
<b>Java e gjashtë:</b>	Mjekimi i sëmundjes iskemike të zezrës Sëmudjet e perikardit Hipertensioni arterial sistemik (primar dhe sekondar)
<b>Java e shtatë:</b>	Sëmudjet e aortës; Sëmudjet e arterieve periferike dhe sëmundjet e sistemit venoz Sëmudjet e qarkullimit mushkëror ; Tromboembolia pulmonare (zemra mushkërore akute)
<b>Java e tetë:</b>	Hipertensioni pulmonar primar; Zemra mushkërore kronike Çrregullimet e ritmit të zezrës: aritmitë supraventrikulare Çrregullimet e ritmit të zezrës: aritmitë ventrikulare
<b>Java e nëntë:</b>	Çrregullimet e përçimit të zezrës; Vdekja e papritur; Reanimimi kardio-pulmonar
<b>Java e dhjetë:</b>	Metodat diagnostike të sistemit respirator Bronkiti akut; Bronkiti kronik Emfizema mushkërore; Bronkiektazitë
<b>Java e njëmbëdhjetë:</b>	Astma bronkiale (ekstrinzike, intrinzike) Pneumonitë (bakterore, virale, mykotike, nga tejndjeshmëria) Sëmudjet e pleurës (pleuritit, empiema, pneumotoraksi)
<b>Java e dymbëdhjetë:</b>	Tumorët e bronkeve, mushkërive Tumoret e mediastinumit ARDS (Sindromi i distresit respirator të të rriturit)
<b>Java e trembëdhjetë:</b>	Sarkoidoza, Ekinokoku Pneumokoniozat (antrakoza, silikoza, azbestoza, berilioza) Pamjaftueshmëria respiratore (akute, kronike)
<b>Java e katërmbëdhjetë:</b>	Etiologjia, patogjeneza dhe ndryshimet patoanatomike të tuberkulozi

	<p>Alergjia dhe imuniteti te tuberkulozi; Testet tuberkulinike; Vaksina BCG</p> <p>Paqyra klinike e TBC dhe format klinike të saj: TBC primar (format e lehta), forma latente, forma manifeste; TBC primar (format e rënda); Pneumonia kazeoz; Bronkopneumonia kazeoze; Kaverna primare;</p>
<b><i>Java e pesëmbëdhjetë:</i></b>	<p>Tuberkulozi limfohematogjen; TBC miliar i mushkërive</p> <p>Komplikimet e TBC Hemoptizia Formimi i bronkiektazive</p> <p>Mjekimi i tuberkulozit: Regjimi higjieno-dietetik; Mjekimi medikamentoz</p>

<b>Plani i dizejnuar i mësimit: Viti i IV-të, Semestri VII</b>	
<b>Java</b>	<b>Ligjerata që do të zhvillohet</b>
<b>Java e parë:</b>	Tumorët e bronkeve, mushkërive; Tumoret e mediastinimit ARDS (Sindromi i distresit respirator të të rriturit)
<b>Java e dytë:</b>	Sëmundjet e ezofagut: Manifestimet klinike dhe ekzaminimet e tjera; Çrregullimet funksionale të ezofagut; Sëmundja e refluksit gastro-ezofageal; Hernia hiatale diafragmale; Divertikujt ezofageal; Anomalitë e lindura të ezofagut; Varikset ezofageale; Dëmtimet korrozive të ezofagut; Tumorët e ezofagut.
<b>Java e tretë:</b>	Sëmundjet e lukthit dhe duodenit: Manifestimet klinike dhe ekzaminimet e tjera klinike; Gastritet dhe Gastropatitë;
<b>Java e katërt:</b>	Sëmundja ulçeroze; Sindroma Zollinger- Ellison; Komplikimet pas rezeksionit të lukthit; Tumorët e lukthit dhe të duodenit.
<b>Java e pestë:</b>	Sëmundjet e zorrëve të holla: Manifestimet klinike dhe ekzaminimet e tjera plotësuese; Sindromi i malabsorbimit; Sindromi diareik; Obstipacioni;
<b>Java e gjashtë:</b>	Enteropatia nga Gluteni (Celiakija); Sëmundja Whipple; Tumorët e zorrës së hollë. Divertikujt e zorrës së hollë dhe zorrës së trashë; Karcinoidet
<b>Java e shtatë:</b>	Sëmundjet e zorrëve të trasha: Sëmundjet inflamatore të zorrëve; Sindromi i kolonit iritabil
<b>Java e tetë:</b>	Tumorët e zorrës së trashë Polipozat e traktit tretës;
<b>Java e nëntë:</b>	Gjakderdhjet gastrointestinale nga pjesa e sipërme dhe e poshtme e traktit tretës; Mjekimi i gjakderdhjeve gastrointestinal
<b>Java e dhjetë:</b>	Sëmundjet e pankreasit: Testet diagnostike morfologjike dhe funksion. Sëmundjet e trashëguara të pankreasit; Pankreatiti akut; Pankreatiti kronik
<b>Java e njëmbëdhjetë:</b>	Tumorët e pankreasit; Karcinoma e pankreasit; Tumorët neuroendokrine të pankreasit; APUD-omat e traktit gastrointestinal.
<b>Java e dymbëdhjetë:</b>	Sëmundjet e mëlçisë: Testet diagnostike, morfologjike dhe funksionale në sëm.hepatike; Sëmundjet metabolike dhe infiltrative të mëlçisë; Hepatitet virale; Dëmtimet toksike dhe medikamentoze të mëlçisë; Sëmundjet auto-immune të mëlçisë; Tumorët e mëlçisë.
<b>Java e trembëdhjetë:</b>	Cirroza e mëlçisë; Hipertensioni portal
<b>Java e katërmëdhjetë:</b>	Sëmundjet e traktit biliar: Kolecistiti dhe kolangjiti; Kalkulozat biliare; Ikteri obstruktiv; Tumorët e fshikëzës biliare dhe rrugëve biliare
<b>Java e pesëmbëdhjetë:</b>	Sëmundjet reumatizmale; Klasifikimi; Poliartiriti të ethet

	reumatike; Artritit reumatoid; Artriti kronik juvenile
<b>Plani i dizajnuar i mësimi:</b> <b>Viti i IV-të, Semestri VIII</b>	
<b>Java</b>	<b>Ligjerata që do të zhvillohet</b>
<b>Java e parë:</b>	Sëmundjet sistemike të indit lidhor: Lupusi eritematoz sistematik; Skleroza sistemike; Polimioziti-dermatomioziti; Vaskulitet.
<b>Java e dytë:</b>	Spondiloartropatitë: Spondiliti ankilozant; Artriti psoriatik; Sindroma Reiter; Artropatia enteropatike; Sëmundja Sjogren;
<b>Java e tretë:</b>	Sëmundjet reumatike degjenerative të nyjeve periferike dhe boshtit kurrizor; Sëmundjet e reumatizmit rrethartikular Sëmundjet metabolike të nyjeve Gihti; Pseudogihti. Osteporoza; Sëmundja Paget.
<b>Java e katërt:</b>	Organet hematopoetike; Sëmundjet e qelizës amë hematopoetike; Sëmundjet e eritrociteve: Anemia sideropenike; Anemitë megaloblastike; Anemitë hemolitike të fituara; Anemitë hemolitike të lindura; Anemia aplastike.
<b>Java e pestë:</b>	Sëmundjet e granulocitëve, monociteve dhe makrofagëve; Sëmundjet e limfociteve, limfomat malinje
<b>Java e gjashtë:</b>	Sëmundjet neoplastike të qelizave që sekretojnë imunoglobulina. Sëmundjet e shprekës; Transplantimi i palcës kockore.
<b>Java e shtatë:</b>	Sëmundjet dhe çrregullimet e hemostazës; Sëmundjet e murit të enëve të gjakut Sëmundjet e numrit dhe funksionit të trombociteve; Çrregullimet e hemostazës
<b>Java e tetë:</b>	Anatomia, fiziologjia dhe metodat diagnostike të sëmundjeve të traktit urinar Sëmundjet e glomerulit renal (primare dhe sekondare) Sindroma nefrotike dhe sindromat e tjera klinike në nefrologji;
<b>Java e nëntë:</b>	Sëmundjet tubulointerstciale të veshkave: Nefropatia endemike; Nefropatia toksike Tuberkulozi i traktit urinar; Infeksionet e traktit urinar: pielonefriti akut dhe kronik;
<b>Java e dhjetë:</b>	Sëmundjet e trashëguara të veshkave; Sëmundjet vaskulare të veshkave; Tumoret e sistemit urinar; Nefrolitiazia; Veshka dhe hipertensioni; Veshka dhe shtatëzania
<b>Java e njëmbëdhjetë:</b>	Pamjaftueshmëria akute e veshkëve; Pamjaftueshmëria

	kronike e veshkëve Hemodializa dhe dializa peritoneale; Transplantimi i veshkës
<b>Java e dymbëdhjetë:</b>	Aspektet klinike të rregullimit endokrin; Sëmundjet hipotalamusit dhe të hipofizës; Tumoret e hipofizës dhe sëmundjet tjera të saj; sëmundjet dhe sindromat më të shpeshta gjatë disfunkcionit hipotalamo-hipofizar (puberteti i parakohshëm, puberteti i vonuar, akromegalia, gjigantizmi, nanizmi, sindroma Sheehan, diabeti insipid, sindroma e sekretimit të papërshtatshëm të ADH) Sëmundjet e gjëndrës tiroide; Hipertireoza; Sëmundja Basedow; Kriza tireotoksike akute; Hipotireoza primare; Struma eutireotike endemike; Tiroiditet akute, kronike; Karcinomat e tiroidesë;
<b>Java e trembëdhjetë:</b>	Hiperparatiroidizmi dhe hipoparatiroidizmi; Çrregullimet e tjera të metabolizmit të fosforit dhe kalciumit. Sëmundjet e gjëndrave mbiveshkore: Sëmundja Addison; Sindroma Cushing; Sindroma Conn; Feokromocitoma; Sëmundjet endokrine me çrregullimet e hormoneve seksuale; Çrregullimet e diferencimit të gjinisë.
<b>Java e katërbëdhjetë:</b>	Diabeti mellitus: tipi I, tipi II, gestacional dhe format e tjera të diabetit; Koma diabetike dhe komplikimet e tjera akute të diabetit; Komplikimet kronike të diabetit; Mjekimi i diabetit
<b>Java e pesëmbëdhjetë:</b>	Sëmundjet e metabolizmit të lipideve, proteinave, porfirinave; Çrregullimet e metabolizmit të ujit dhe elektroliteve; Çrregullimet e ekuilibrit acidobazik Ateroskleroza, obeziteti, kaheksia; Helmimet

<b>Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:</b>
<b>Konform statutit të UP-së.</b>